

VENDIM
Nr. 411, datë 15.6.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 79, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE 1, ZONA AUTOTRAKTORI, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nënndarjeve “iii” dhe “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, e të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 79, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet, si më poshtë vijon:

“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, Njësia Administrative 1, zona autotraktori, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e shoqërisë “Tirana DC” sh.a. si njësi zbatuese.”.

2. Në pikën 2, fjalët “... Bashkisë Tiranë ...” zëvendësohen me “... shoqërisë “Tirana DC” sh.a., ...” .

II. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Bashkia Tiranë dhe shoqëria “Tirana DC” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj